



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 110
Prishtinë, më 4, 5, 10 dhe 11 prill 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 4, 5, 10 DHE 11 PRILL 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Fadil Demaku, Nazane Breca, Ramë Vataj, Teuta Sahatqija, Ramiz Lladrovci, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Blerta Deliu-Kodra, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi, Halit Krasniqi, ministri Fehmi Mujota dhe ministri Agim Çeku, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Ganimete Musliu parashtrroi pyetje për ministrin Ibrahim Makolli në lidhje me regjistrimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët jetojnë në Diasporë. Ministri Ibrahim Makolli iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me numrin e pjesëtarëve të TMK-së, të cilët nuk janë sistemuar në punë, duke i përjashtuar edhe ata që e marrin pensionin e parakohshëm.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj në lidhje me akreditimin e ambasadorëve të Republikës së Kosovës, të cilët pas përfundimit të procedurave të parapara ligjore ende mbeten në Prishtinë.

Ministri Enver Hoxhaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Enis Kervan parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja në lidhje me moszbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe kutikulës në lidhje me përdorimin e gjuhës turke.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetit Enis Kervan.

Deputetja Ganimete Musliu parashtoi pyetje për ministrin Ibrahim Makolli në lidhje me organizimin e arsimit në gjuhën shqipe në Diasporë dhe deri ku është arritur me procesin e realizimit të kësaj iniciative..

Ministri Ibrahim Makolli iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me hapat që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë që Spitali Rajonal në Mitrovicë të jetë funksional për ofrimin e shërbimeve kualitative profesionale shëndetësore.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me veprimet e deritashme të Ministrisë së Shëndetësisë për përmirësimin e furnizimit me ushqim kualitativ, pastërtisë dhe mirëmbajtjes në QKUK, kushteve të punës për personelin shëndetësor dhe përmirësimin e furnizimit me barna, si dhe për renovimin dhe sanimin e gjendjes së ashensorëve ekzistues në QKUK.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e pagesave,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin e duhanit,
5. Interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, sipas kërkesë së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dyshimet për keqpërdorimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfshirë kontratën e pasaportave biometrike me kompaninë austriake (OeSD),
6. Debat parlamentar lidhur me raportet e institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës,
7. Debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
8. Debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimtarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues,

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjin nr. 04-L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012,
13. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve joshumicë dhe joserbe për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e tyre.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e pagesave

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për sistemin e pagesave.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, e paraqiti kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për sistemin e pagesave.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin e duhanit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për kontrollin e duhanit.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e paraqiti nënkryetarja e këtij komisioni, deputetja Time Kadrijaj.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi, Time Kadrijaj, Liburn Aliu, Shaip Muja, Bekim Haxhiu, Bahri Thaçi, Zenun Pajaziti, Berat Buzhala, Teuta Sahatqija, Kurtan Kajtazi, Nazane Breca, Sadri Ferati, Armend Zemaj, Sala Berisha-Shala, Lutfi Haziri, Fadil Demaku, Vjosa Osmani, Blerta Deliu-Kodra, Ganimete Musliu, Xhavit Haliti dhe ministri Ferid Agani, diskutimi i plotë i të cilëve është dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim veç e veç amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12,13,14, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 23 A, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37 dhe 38.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet nr: 20, 22 dhe 30.

Deputeti Ardian Gjini e tërhoqi amendamentin me numër 22B, të propozuar nga ai.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për kontrollin e duhanit.

5. Interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, sipas kërkesë së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dyshimet për keqpërdorimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfshirë kontratën e pasaportave biometrike me kompaninë austriake (OeSD),

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për interpelancë me ministrin Bajram Rexhepi lidhur me dyshimet për keqpërdorimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfshirë kontratën e pasaportave biometrike me kompaninë austriake (OeSD).

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti **Rexhep Selimi**, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se kjo Qeveri është qeveria më e korruptuar pas luftës. Në këtë Qeveri, Ministria e Punëve të Brendshme është ministria më e korruptuar e saj.

Kur ka aq shumë korrupsion në një institucion, që duhej ta luftonte korrupsionin, edhe vetë fjala korrupsion bëhet e pamjaftueshme. Në vargun e gjatë të skandaleve jemi të përqendruar në njërin nga ato skandale, që nuk ngelur i fundit, e që ka të bëjë me kontratën e furnizimit të pasaportave elektronike, respektivisht me korrupsionin në kontratën e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Oesterreichische Staatsdruckerei, me vlerë prej 14 127 003,24 centë, ku mbi 1,4 milion përfunduan në duart e qeveritarëve si ryshfet, që i bie fiks 10% e vlerës së tenderit.

Në nëntor të vitit 2012 u bë e ditur se Ministria e Punëve të Brendshme kishte paguar 1,4 milion e më shumë euro në llogarinë e shtetases gjermane Natali Velijaj, në emër të kontratës me kompaninë austriake OeSD, të cilat ajo më pastaj nuk i kishte dërguar te kompania

austriake. Në Prokurori, zonja Velijaj deklaroi se ato 1,4 milion ishin të destinuara për zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Qeverisë si rryshfet për ta fituar kontratën.

Përveç dëmeve të tjera, duke e dëmtuar procesin e prodhimit të pasaportave biometrike, Qeveria e ka dëmtuar seriozisht procesin e liberalizimit të vizave me shtetet e Shengenit, ku një prej kushteve kryesore është pikërisht ofrimi i pasaportave biometrike. Dy muaj pas publikimit të skandalit është shkëputur kontrata me kompaninë austriake, OeSD.

Më 5 maj 2012 hetohen zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamenti Antikorrupsion i Policisë së Kosovës ka kërkuar informata për udhëtimin jashtë vendit të 4 zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët dyshohet se e kanë keqpërdorur pozitën zyrtare gjatë udhëtimeve jashtë vendit.

Më 16 maj 2012, Ministria e Punëve të Brendshme i falsifikoi edhe ditëlindjet. Ndryshimet e ditëlindjeve dhe statuseve pensionale nga një komision i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mënyrë kundërligjore kanë bërë që Misioni i Bashkimit Evropian për forcimin e ligjit në Kosovë t'i nisë hetimet lidhur me këtë shkelje.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është arrestuar një zyrtar për marrje rryshfeti në procesin e riatdhesimit. Në ndërkohë, ministria e pranon se ka dështuar procesi i riatdhesimit.

Ministria e Punëve të Brendshme vazhdon t'i "shpërblejë" me tenderë kompanitë që ofrojnë çmime më të larta. Tenderin për furnizim me targa për automjete kjo ministri ia ka dhënë një kompanie, edhe pse ishte mbi 300 mijë euro më e lartë se sa oferta tjetër, ashtu siç kishte vepruar edhe tre vjet më herët.

Më 17 tetor 2012, dhunë ndaj deputetëve dhe aktivistëve të Lëvizjes "Vetëvendosje". Bajram Rexhepi jep urdhra direkt operative, e dhunon verbalisht edhe Kuvendin e Kosovës duke u kërcënuar se do të vazhdojë me urdhra të tjerë.

Më 22 tetor 2012, rreth 8 orë dhunë, gaz e lotsjellës, rreth 50 të arrestuar, rrahje të deputetit Liburn Aliu, lëndime të të ¼-ve të deputetëve të Lëvizjes "Vetëvendosje" e të tjerë. Pra, në këtë dhunë mbeti e lënduar rëndë edhe shtetasja gjermane, e cila akoma gjendet në koma.

Në ndërkohë, pati edhe ndërhyrje direkte në drejtësi e deri edhe në ndërhyrjen e mbrojtjes së të akuzuarës, e cila tashmë nuk po guxon të flasë. Sot në këtë interpelancë, Kuvendi i Kosovës e ka rastin që duke i mbështetur rekomandimet e këtij mocioni t'i japë fund korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe t'i japë një mundësi luftimit të korrupsionit, duke filluar nga kjo ministri, e duke mos u ndalur vetëm aty.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme ta marrë fjalën.

Ministri **Bajram Rexhepi** fjalën e tij e filloi me sqarimin se ai do t'i përmbahet kërkesës së parashtruar për interpelancë.

Rasti i pasaportave biometrike - Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2010 kishte iniciuar kërkesë për furnizim me pasaporta elektronike biometrike, duke e përdorur procedurën me dy faza të tenderimit.

Në fazën e parë të tenderimit, dosjen e tenderit e kishin kërkuar 42 kompani dhe prej tyre 12 kompani kanë konkurruar. Komisioni i vlerësimit kishte parakualifikuar 6 kompani të

përgjegjshme. Në bazë të Ligjit mbi prokurimin publik kemi bërë ftesën për ofertim 6 kompanive të përgjegjshme. Bundes Druckerei - Gjermani, AKD - Kroaci, GND - Gjermani, Oesterreichische Staatsdruckerei - Austri, CEPTIS - Slloveni dhe Siemens - Austri.

Në fazën e dytë, prej 6 kompanive të parakualifikuara kishin ofertuar 4 kompani.

- AKD & KIG ICT - Kroaci me çmimin total prej 15 754 830 euro,
- CEPTIS - Slloveni me çmimin prej 13 673 199 euro,
- GND - Gjermani me çmimin total prej 15 955 520 euro dhe
- Oesterreichische Staatsdruckerei me çmimin total prej 14 127 003 euro.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave prej katër kompanive, të cilat kishin ofertuar, një kompani e kishte eliminuar nga gara dhe tri kompani i kishte vlerësuar të përgjegjshme.

Prej 3 kompanive të përgjegjshme, komisioni kishte rekomanduar ofertën me çmimin më të lirë, e që ishte kompania Oesterreichische Staatsdruckerei me çmimin prej 14 127 003 euro. Më pas me çmim ishte kompania AKD dhe GND.

Më pas, MPB-ja, në vitin 2011, e kishte lidhur kontratën me Oesterreichische Staatsdruckerei për furnizim me pasaporta elektronike. Duke u bazuar në nenin 5 të kontratës së nënshkruar dhe Ligjin mbi prokurimin publik, kompania Oesterreichische Staatsdruckerei e kishte për obligim ta ketë përfaqësinë e regjistruar në Kosovë dhe në bazë të këtij kushti, Oesterreichische Staatsdruckerei e kishte njoftuar MPB-në për përfaqësuesin e tij në Kosovë. Ministria e Punëve të Brendshme më 8 nëntor 2011 dhe 29 nëntor 2011 e ka pranuar autorizimin e lëshuar nga kompania Oesterreichische Staatsdruckerei, me të cilën e autorizon Consalting EU SHPK me numër biznesi 70776480, adresa 'Xh. Rekalja', 32000 në Prishtinë, si përfaqësues zyrtar të kompanisë Oesterreichische Staatsdruckerei, si dhe me marrëveshjen shtesë të datës 6 dhjetor 2011, në të cilën është përcaktuar xhirollogaria e përfaqësuesit zyrtar të OeSD-së, ku do të kryhen obligimet financiare të OeSD-së nga MPB-ja.

Nga kjo datë, MPB-ja të gjitha obligimet financiare ndaj kompanisë Oesterreichische Staatsdruckerei i ka kryer duke bërë pagesat në xhirollogarinë vendore të kompanisë Consalting EU SHPK, si përfaqësues zyrtar i kompanisë Oesterreichische Staatsdruckerei. Gjatë kësaj periudhe, MPB-ja në llogari të Consalting EU ka paguar 7 fatura në vlerë prej 3 361 283 euro. Të gjitha këto fatura ishin paguar në llogarinë e Consalting EU dhe asnjëherë më herët Oesterreichische Staatsdruckerei nuk kishte kundërshtuar. Ndërkohë, gjatë muajit gusht 2012 jam informuar nga ambasadori austriak në Prishtinë lidhur me ankesën e kompanisë Oesterreichische Staatsdruckerei, sipas të cilave një shumë e mjeteve financiare në vlerë prej 1,4 milion euro nuk është transferuar në xhirollogarinë bankare të kompanisë.

Rasti pastaj ka kaluar në kompetencë të prokurorit të EULEX-it dhe gjatë gjithë procesit e kemi ofruar dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces hetimor dhe me të drejtë presim përmbylljen e këtij rasti dhe ngritjen e aktakuzës për personat e dyshuar, të përfshirë në këtë rast.

Në vazhdim ai dha sqarime rreth çështjes së taksave doganore TVSH-së, për të konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme konsideron se nuk ka mundësi të ndryshohen termet e referencës së dosjes së tenderit dhe kontratës, dhe paraqiti para Kuvendit masat për tejkalimin e situatës.

Në vazhdim, ai foli edhe për rastin tjetër, atë të rastit të blerjes së armëve, rreth hetimit që ka të bëjë me dyshimet për keqpërdorim të blerja e armëve dhe municionit, prokurimi ka pak për çfarë të deklarohet, edhe pse formulimi nga kërkuesi i interpelancës ka disa pasaktësi.

Deri më tani ende nuk ka ngritje të aktakuzës dhe as konfirmim nga gjykata kompetente. Kjo nënkupton që pretendimet e ngritura duhet të vërtetohen.

Asnjë dokument apo dosje e përfolur në media nuk është vjedhur apo shkatërruar, sepse në fakt në Dhomën e Dëshmimeve as që ka pasur dosje të rasteve ndonjëherë. Hetimet për këtë rast janë udhëhequr nga prokurori i EULEX-it, i quajtur Françesko Mandoi, dhe veprimet hetimore janë kryer nga hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda të Policisë së Kosovës deri më 2 shtator 2009, kur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që rasti të kalojë në kompetencë hetimore të Policisë së EULEX-it.

Ministri Rexhepi foli edhe për tenderin për furnizim me targa, për regjistrimin e automjeteve gjatë vitit 2012 kanë ofertuar gjithsej 3 kompani, si dhe për Raportin e Auditorit, punimet për Qendrën e Regjistrimit, kontratat për furnizim me ushqim dhe pije. Më tej, paraqiti konstatimin se përkundër shumë sfidave me të cilat jemi përballur, Ministria e Punëve të Brendshme në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime konkrete, me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të performansës, duke adresuar rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm, ndryshimet në stafin menaxhues suspendimin e kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e ministrit Bajram Rexhepi.

Ganimete Musliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se debatet për çështje të ndjeshme si këto të sigurisë dhe punëve të brendshme duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe assesit të mos keqpërdoren si terren i mundshëm me qëllim të fushatës elektorale.

Duke pasur parasysh se jemi në një fazë shumë të rëndësishme të zgjidhjes së problemit të veriut dhe shuarjes së strukturave ilegale të sigurisë, ne prapë kemi kërkesa nga subjektet e mendësisë së vjetër për të krijuar vakuum institucional, me synim degradimin e institucioneve të sigurisë në vend, andaj Partia Demokratike e Kosovës e konsideron sundimin e ligjit dhe ligjshmërinë në vend si opsion që nuk ka alternativë tjetër.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ju ftoj të votoni kundër këtyre rekomandimeve, sepse çdo votim pro i këtyre rekomandimeve i cenon këto parime, të cilat vetë i kemi votuar në këtë Kuvend.

Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se në rrafshin teorik, nga Ministria e Punëve të Brendshme janë promovuar prioritetet strategjike, siç janë ndërtimi i infrastrukturës ligjore, siguri i zbatimit të ligjit, mbrojtja e jetës dhe pronës, liria e lëvizjes, parandalimi dhe reduktimi i krimit, garantimi i rendit dhe sigurisë publike, zhvillimi i administratës efektive, bashkëpunimi me agjencitë dhe organizatat përkatëse të Bashkësisë Evropiane, të gjitha këto prioritet me qëllim të përmbushjes së misionit dhe kujdesit për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike,

Por, rezultatet janë në shpërputhje, sepse gjendja në terren është krejt ndryshe nga ajo që ju e prezantoni dhe se përgjegjësia duhet të fillojë nga ju.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, tha se njëra prej çështjeve për shkelje të shumta, të cilat janë vlerësuar nga Auditori i Përgjithshëm, e që ndërlihen

drejtpërdrejt me Ministrinë e Punëve të Brendshme ka të bëjë edhe me skandalin e pasaportave, por edhe me çështjet tjera.

Për shembull te kompania NNT Albese, e cila qartë, sipas Auditorit, në ofertën e vet ka afruar çmime joreale, pra që janë në kundërshtim të plotë me çmimet në treg dhe rrjedhimisht sipas nenit të prokurimit publik dhe nenit 61 të Ligjit për prokurimin publik, atëherë organet e Ministrisë është dashur të kërkojnë me shkrim shpjegime shtesë për këto çmime dhe për përmirësimin e këtyre çmimeve, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast, domethënë projekti ka vazhduar, përkundër kësaj shkeljeje të Ligjit për prokurimin publik.

Por, një çështje më e rëndësishme që më duket mua është një mospërputhje ndërmjet datave, për shkak se këto i përmendi edhe ministri, domethënë iu referua edhe raportit të Auditorit dhe çështjeve tjera. Sipas kontratës së nënshkruar me kompaninë OeSD, ata është dashur që deri më 27 shtator 2011 ta hapin përfaqësinë e tyre këtu, ose ta regjistrojnë një kompani që do të jetë përfaqësuese e tyre në Kosovë, domethënë ta regjistrojnë në regjistrin e biznesit në Kosovë, gjë që nuk ka ndodhur.

Çështja tjetër, kur nuk është ndërprerë kontrata në shtator të vitit 2011, atëherë pse Ministria ka hyrë në aso marrëveshje tjera me të cilat ka shërbyer në njëfarë mënyre edhe si importues i pajisjeve që do t'i përdorte kompania për shtypjen e pasaportave në Kosovë? Për shkak se figuron në regjistrin e doganave, pra MPB-ja figuron si importues i pajisjeve të kompanisë, gjë që thuhet edhe në raportin e auditimit, ndërkohë që Ministria po refuzon ta pranojë se ka qenë importues, përderisa një kompani tjetër, që e ka kryer rolin e shpeditimit, në këtë rast 'Shala-Kompani', thotë që ka shërbyer si shpeditues i Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila i ka importuar këto pajisje dhe pastaj e ka importuar edhe letrën, e cila është përdorur për t'i shtypur pasaportat biometrike këtu në Kosovë.

Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se subjekti që ai përfaqëson gjatë krejt këtyre viteve ka qenë i palëkundur në vizionet, planet, propozimet dhe idetë e shumta që i ka shtruar në publik për përmirësimin e gjendjes, të sundimit të ligjit në tërësi, sikur edhe përmirësimin e qeverisjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme, si njëra prej ministrive kyçe, në veçanti dhe nuk mund të heshtim kur bëhet fjalë për degradimin e këtij institucioni, nuk mund t'i mbylлим sytë kur bëhet fjalë për gabimet e panumërta që po ndodhin vitet e fundit, nuk mund të mos reagojmë ndaj dështimeve të çdoditshme që po i vërejmë në këtë sektor vërtet të rëndësishëm të shtetit.

Në vazhdim tha se ministri Rexhepi, jo vetëm që nuk arriti ta zbatojë ligjin në pjesën më të ndjeshme të vendit për shkak të situatës së ndjeshme në veri të Kosovës, por realisht Ministria e tij u bë ndër kampionët kryesorë të shkeljes së ligjit, me tenderë të dyshimtë, me punësime personale e partiake, me super-paga për asistente, me ndërhyrjet politike në Policinë e Kosovës, mungesën e politikave për zhvillimin e Policisë, nuk u ndal ndërhyrja edhe në çështjet operative. Të gjithëve na kujtohet se si ministri Rexhepi është sjellë si komandat i njësitit kur u jepte urdhra direkte policëve, në sytë e kamerave.

Grupi Parlamentar i AAK-së do të votojë pro mocionit për shkarkimin tuaj, edhe pse, po e përsëris, e kemi të qartë rregullimin kushtetues për këtë çështje.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se në kërkesën për interpelancë kërkohet shkarkimi i ministrit Rexhepi, mirëpo ne mjaft mirë e dimë që ministri

është i ngarkuar në postin e ministrit nga vetë kryeministri dhe kryeministri është njëri përgjegjës për punën e ministrave brenda Kabinetit.

Në rast se e shohim pikën 2 të tekstit të mocionit - Kuvendi e fton Prokurorinë e Kosovës për t'i hetuar skandalet dhe përgjegjësitë ligjore të ministrit Rexhepi në të gjitha projektet e lartpërmendura, atëherë Aleanca për Kosovën e Re është që Kosova të funksionojë si shtet ligjor, andaj kërkojmë nga institucionet përgjegjëse zbatimin e ligjit, përkatësisht organet e drejtësisë ta hetojnë me profesionalizëm rastin e aferës së pasaportave dhe t'i përmbushin obligimet e tyre kushtetuese, që si institucione të pavarura t'i ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

AKR-ja kërkon që çështja e pasaportave në Ministrinë e Punëve të Brendshme të qartësohet, ndërsa përgjegjësit të dalin para organeve të drejtësisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Arsim Bajrami, Hykmete Bajrami, Albin Kurti, Donika Kadaj-Bujupi, Valbona Dibra, Vjollca Krasniqi, Teuta Sahatqija, Rexhep Selimi dhe ministri Bajram Rexhepi**, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, në emër të propozuesit të interpelancës, deputeti Rexhep Selimi e paraqiti tekstin e propozim-Rezolutës.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 34,
Kundër ----- 51,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dyshimet për keqpërdorimet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përfshirë kontratën e pasaportave biometrike me kompaninë austriake (OeSD).

Në fund të kësaj interpelance, kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen për ditën e sotme, në orën 18:25, për të vazhduar nesër, më 5 prill 2013, në orën 10:00.

E premte, më 5 prill 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 4 prill

Kryetari procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës, si në vijim:

6. Debat parlamentar lidhur me raportet e institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me raportet e institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë.

Ai e ftoi përfaqësuesen e Grupit Parlamentar të LDK-së që në cilësinë e propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

Vjosa Osmani, në cilësinë e propozuesit të çështjes, tha se institucionet ndërkombëtare, në veçanti ato evropiane, në baza vjetore i publikojnë raportet e tyre për zhvillimet në Kosovë.

Një numër i këtyre raporteve kanë rëndësi fundamentale për ecjen përpara të Kosovës si shtet, meqë pasqyrimi i zhvillimeve në vendin tonë në ato raporte e përcakton edhe suksesin e Kosovës drejt anëtarësimit në organizata ndërkombëtare dhe fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit.

Imazhi ndërkombëtar i Kosovës që tani paraqitet në shumicën e këtyre raporteve është shumë i zymtë. Në pothuajse çdo raport mbizotërojnë vlerësimet për nivelin e lartë të krimit dhe korrupsionit në vendin tonë.

Duke marrë si shembull disa nga raportet që kanë më së shumti rëndësi për Kosovën, siç e dini, raporti i fizibilitetit, i publikuar në vitin 2012, thekson se për t'i përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të ketë angazhim të besueshëm për të ndërmarrë reforma demokratike, në veçanti për zgjedhje të lira dhe të rregullta. Aty konfirmohet se zgjedhjet e fundit parlamentare u shënuan me mangësi serioze dhe vështirësi teknike dhe për më tepër ndër kërkesat kryesore të këtij raporti është rritja e rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi Qeverinë.

Moskoordinimi ndërmjet institucioneve të shumta që janë krijuar kinse për luftimin e korrupsionit nuk ka ndikuar në uljen e këtij fenomeni sipas këtij raporti.

Në anën tjetër, rezoluta me rekomandime e Këshillit të Evropës, që nga Ministria e Punëve të Jashtme është paraqitur si një hap drejt anëtarësimit në këtë organizatë, e cilëson Kosovën si vend ku progresi në fushën e sundimit të ligjit është i ngadalshëm, në veçanti sa i përket luftës kundër krimit dhe korrupsionit dhe Gjyqësori vazhdon të ballafaqohet me ndërhyrje politike, joefikasitet, mungesë transparence dhe mungesë të ekzekutimit të vendimeve.

Mirëpo, ka të dhëna në këtë rezolutë dhe rekomandime që nuk e paraqesin realitetin në Kosovë, për të cilat institucionet e Kosovës duhet të kujdesen që të mos figurojnë në raportet e ardhshme.

Në anën tjetër, raporti për liberalizimin e vizave, po ashtu i publikuar nga Komisioni Evropian, ka paraqitur edhe afro 80 kritere që kanë mbetur të paplotësuar, e që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me ripranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar, sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e kufirit, menaxhimin e migracionit, azilin, bashkëpunimin rreth zbatimit të ligjit dhe në çështje penale, mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtave të njeriut, e në veçanti të lirisë së lëvizjes.

Kryetari e hapi debatin parlamentar.

Blerta Deilu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se shteti i Kosovës e ka forcuar subjektivitetin e tij ndërkombëtar, duke qenë i njohur gati nga gjysma e vendeve të

botës, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, të G-20, shtetet e rajonit dhe më gjerë.

Shteti e ka një të ardhme të sigurt evropiane dhe euroatlantike dhe ka bërë hapa të rëndësishëm drejt anëtarësimit në BE dhe në NATO dhe tashmë është anëtar i Bankës Botërore, i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i EBRD-së, i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe rajonale.

Po ashtu, në vitin 2012, Kosova e arriti sovranitetin e plotë, duke e përfunduar me sukses fazën e mbikëqyrjes ndërkombëtare, që dëshmoi se është dhe do të mbetet një storie e suksesit.

Vlen të theksohet se rezultatet e studimit të fizibilitetit u vlerësuan pozitivisht nga Bashkimi Evropian dhe ju ftojme ta lexoni me kujdes edhe dokumentin e Komisionit Evropian për studim të fizibilitetit të Kosovës të datës 10.10.2012, ku të gjeturat tregojnë se Kosova i ka arritur kushtet për t'u përfshirë në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Dokumenti e përshkruan progresin që Kosova e ka arritur në tre vjetët e fundit dhe thuhet: "Kosova është e gatshme për t'i filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit".

Në ndërkohë, ne i plotësuam edhe prioritetet afatshkurtra, gjë e cila u konfirmua nga komisionari për Zgjerim, Fyle, më 19 mars 2013.

Progresi i shtetit të Kosovës, diplomacia aktive dhe partneriteti me aleatët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, po japin rezultate për rritjen e numrit të njohjeve dhe angazhimi ynë do të përqendrohet në anëtarësimin e Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, si dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se duke iu referuar disa raporteve, si raporti i fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian, pastaj raportit të Freedom House, si dhe raporteve të Bankës Botërore, Kosova po ballafaqohet me sfida kryesore, si sundimin e ligjit, krimin e organizuar, korrupsionin, varfëria, papunësia e madhe, deficitin tregtar, si dhe zhvillimi jo i mirë ekonomik.

Sipas raportit të fizibilitetit, Kosova mbetet një vend origjine dhe transiti për viktimat e trafikimit, pastaj mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë është një sfidë veçanërisht e vështirë dhe, në përgjithësi, lufta kundër krimit të organizuar është një sfidë madhore për Kosovën.

Qeveria e Kosovës, por edhe institucionet tjera përgjegjëse, ende nuk po mund t'i eliminojnë vërejtjet të cilat po raportohen nga organizatat më të fuqishme ndërkombëtare, me të cilat kërkohet që Kosova ta përmirësojë qeverisjen e saj.

Sistemi i gjykatave vazhdon të vuajë nga dobësitë strukturore dhe autonomia e sistemit juridik mbetet ende e brishtë.

Shteti i ri, në bazë të vlerësimeve të jashtme, nuk është në rrugën e duhur drejt funksionalitetit, kurse vlerësimet që vijnë nga raportet ndërkombëtare janë vërejtje esenciale dhe prekin fushat thelbësore të shtetësisë.

Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", tha se imazhi i Kosovës, sipas raporteve ndërkombëtare, gjatë viteve të fundit ka qenë i zymtë. Shumica e

këtyre analizave që kanë pasur për fokus zhvillimet në Kosovë nuk flasin mirë për këto zhvillime.

Për më tepër, sipas këtyre vlerësimeve, Republika e Kosovës, jo vetëm që nuk ndodhet në rrugë të duhur sa i përket instalimit të shtetit ligjor, funksionalitetit të shtetit dhe krijimit të një rendi demokratik përmbajtjesor, por fatkeqësisht shteti ynë madje ka shënuar edhe hapa prapa në këtë drejtim dhe këto vlerësime prekin pikërisht disa nga sferat më substanciale të shtetësisë.

Sidoqoftë, përtej lojës së pakuptimtë dhe retorikës propagandistike të kësaj Qeverie për arritjet historike të Kosovës nën drejtimin e saj, të gjitha raportet ndërkombëtare që e vlerësojnë funksionalitetin shtetëror të Kosovës e thonë të kundërtën.

Kështu, disa nga raportet e organizatave të njohura, që u përmendën, si Freedom House, Reporters Without Borders, Media Freedom Index, Transparency International, raportet e progresit, ato të të drejtave të njeriut, vazhdimisht e kanë theksuar dështimin e shtetit të Kosovës në plotësimin e standardeve demokratike, dhe sidomos kur dihet se raportet e këtyre institucioneve i karakterizon një kredibilitet i lartë i vlerësimeve profesionale.

Për dallim prej raportit të vitit 2009, në vitin 2011, revistat prestigjioze ndërkombëtare, si Foreign Policy Magazine, përpos që e përmend përsëri mungesën e progresit në këtë sferë, ai tashmë e shton edhe një tipar tjetër, atë të pushtimit edhe të kësaj sfere nga niveli i lartë i korrupsionit. Argument më të fuqishëm lidhur me dështimin strukturor për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme sesa ky fakt besoj se nuk nevojitet.

Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se meqenëse bëhet fjalë për raportet ndërkombëtare, ajo i ka analizuar pesë raporte të tilla, të cilat flasin për Kosovën dhe zhvillimet aty, duke filluar nga raporti i Departamentit të Shtetit, e deri te dokumenti punues i stafit të Komisionit dhe komunikata e Komisionit për studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës.

Fjalët kyçe në këto raporte i kam nxjerrë dhe thonë: korrupsioni në Qeveri; influenca politike në sektorët e sigurisë; në ndërmarrjet publike; në bordet e pavarura; në Gjyqësor, dhe së fundi, krim i organizuar, trafikim dhe drogë. Do të thotë, në 5 raporte janë fjalët kyçe, të cilat e përshkruajnë Kosovën dhe zhvillimet në të.

Këto raporte nuk dallojnë, sepse e kam bërë një krahasim, as me raportin e vitit 2009, 2010, 2011 dhe 2012, nuk ka asnjë përmirësim.

Shtetet e dështuara janë ato shtete ku Qeveria nuk e kontrollon territorin e vet, dhe besoj që ajo po i përngjan shumë Kosovës; ku Qeveria e ka një korrupsion shumë të lartë, dhe besoj që po i përngjan shumë Kosovës; ku kemi trafikim në nivel të krimit të organizuar të qenieve njerëzore, dhe besoj se po i përngjan vendit tonë; ku papunësia për çdo ditë rritet dhe të gjithë qytetarët që jetojnë këtu e kuptojnë se po flitet për vendin tonë.

Ajo kërkoi që ky trend të ndalet, sepse as qytetarët e Kosovës, as gjeneratat para nesh, fëmijët tanë, nuk e meritojnë të radhiten në mesin e shteteve të dështuara.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të KKR-së, tha se nëse këtë debat e shohim vetëm nga një prizëm që Kosova është vetëm e Qeverisë, atëherë do të ishte gabim shumë i

madh, sepse Kosova është e gjithë qytetarëve të saj dhe besoj se asnjë raport i mirë apo i keq nuk e etiketon vetëm një person, por etiketohet Kosova si tërësi.

Në rast se flasim për këto raporte, ne po i diskutojmë si Raportin e Progresit, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, i kemi diskutuar në Kuvendin e Kosovës dhe mund të themi se në rast se përsëriten të njëjtat gjëra, atëherë nuk kemi arritur asgjë. Gjuajmë akuza prej njëres palë te tjetra, mirëpo esenca është ta përmirësojmë çështjen nga vetvetja dhe pastaj drejt institucioneve, siç janë Qeveria, Kuvendi dhe Gjyqësori.

Në rast se flasim në efekt, si e shohin Kosovën shumë raporte, atëherë mund të themi se nuk jemi të kënaqur të gjithë. Mirëpo, çfarë mbetet? Mbetet që të punojmë si pozitive dhe opozitive, që Kosova në këto raporte të jetë në pozicione më të larta.

Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se është me rëndësi të përballemi me të gjitha vlerësimet, qofshin ato pozitive apo negative, të institucioneve ndërkombëtare për zhvillimet në Kosovë.

Sipas standardeve evropiane, nëse të drejtat e minoriteteve në një shoqëri nuk janë ato të nivelit të tillë, atëherë nuk mund të pritet që zhvillimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi të jetë i avancuar.

Në vazhdim, ai u fokusua në çështjen që lidhet me pasurinë e manastirit të Deçanit, vendimeve të gjykatave lidhur me këtë çështje, çështjes së të drejtave të realizuara për komunitetin serb në Kosovë, çështjen e komunave të reja me shumicë serbe të formuara sipas planit të Ahtisarit dhe çështjen e përqindjes së të punësuarve të komunitetit serb në institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Natyrisht se në këtë drejtim ka edhe arritje të konsiderueshme, siç janë: Zbatimi me sukses i planit të presidentit Ahtisari, formimi i komunave të reja me shumicë serbe, formimi i Zyrës për Barazinë e Gjuhëve dhe fillimi i punës së kanalit televiziv në gjuhën serbe, i cili pritet të realizohet së shpejti, theksoi nënkryetari i Kuvendit, Petar Miletqi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Xhevahire Izmaqi, Teuta Sahatqija, Albulena Haxhiu, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Jakup Krasniqi, Burim Ramadani, Armend Zemaj, Hydajet Hyseni, Hashim Deshishku, Petar Miletqi, Bahri Thaçi, Sadri Ferati, Lirije Kajtazi, Nazane Breca, Shaip Muja, Hykmete Bajrami, Vjollca Krasniqi, Alma Lama, Emilija Rexhepi, Kymete Bytyçi dhe Kurtan Kajtazi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetja Vjosa Osmani, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit e paraqiti tekstin e rekomandimeve për miratim nga Kuvendi.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e propozuara nga deputetja Vjosa Osmani. Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër -----0,
Abstenime -----3.

Kryetari Konstatoi se Kuvendi nxori këto:

REKOMANDIME

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë veprime konkrete për adresimin dhe plotësimin e kriterëve të mbetura të paraqitura në Raportin e Fizibilitetit, Raportin për Liberalizimin e Vizave, Rezolutën e Këshillit të Evropës dhe në raportet e tjera kredibile ndërkombëtare.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës në baza tremujore t'i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për të arriturat në plotësimin e këtyre kriterëve.

7. Debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri me 10 qershor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se tjetërsimi i pronës publike dhe shoqërore në kundërshtim me vullnetin e popullit është krim ndaj këtij vendi dhe popullit të tij. Andaj, njohja e tjetërsimit të kësaj prone nga strukturat e regjimit shtypës të Milosheviqit është legalizim i krimit të bërë ndaj këtij populli.

Ndër më të rëndësishmet është sqarimi i raportit të shtetit tonë me periudhën e viteve ‘90 dhe me regjimin shtypës të Milosheviqit. Si e trajtojmë ne këtë regjim? E njohim atë si regjim pushtues, apo si legjitim?

Dhe, mendoj se deklarimi në këtë pikë është i domosdoshëm nga deputetët pa dallime politike, etnike. Mostrajtimi shtetëror i këtyre vlerave i zbeh ato duke lejuar që të shpërndara të trajtohen si prona të partive, grupeve e individëve. Lënia më një anë dhe qëndrimi i heshtur në këtë pikë vetëm sa ndikon në fuqizim të vendimeve diskriminuese të pushtetit të Milosheviqit.

Diskutimi dhe vendimet sot janë tejet me rëndësi edhe për raportet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, raporte këto që periudha e pushtimit serb i ka dëmtuar rëndë. Prandaj, për cilindo qytetar të Kosovës ka rëndësi të madhe sot se çka mendojnë dhe si deklarohen deputetët e këtij Kuvendi.

Në vazhdim, ai u fokusua në rrjedhat e fundit të viteve të ‘80-ta që përfunduan me suprimimin e kësaj autonomie të Kosovës së vitit 1989, pushtimin serb populli shqiptar në Kosovë e priti me rezistencë gjithëpopullore. Vrasjet, helmimet, burgosjet dhe largimet nga puna, në njërin anë, dhe protestat, grevat dhe padëgjueshmëria, në anën tjetër, u bënë pjesë e jetës. Serbia në mënyrë të dhunshme dëboi nga puna mbi 150 mijë punëtorë. Vendosi në krye të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore drejtues të tjerë, si pasojë e masave të dhunshme që i zbatonte në Kosovë.

Pjesë e aplikimit të kësaj politike nacionaliste kundrejt shqiptarëve ishin edhe të ashtuquajturat kontrata të dhurimit, nëpërmjet të cilave ndodhi tjetërsimi i pronës shoqërore në atë private.

Ndërmarrje të shumta shoqërore e që në vete përfshijnë asete të ndryshme, qoftë tokë, objekte të ndërtuara apo pajisje dhe makineri pune kaluan anë pronë private.

E përbashkëta e këtyre tjetërsimeve ishin përfituesit serbë të lidhur me shtetin e Serbisë.

Rasti më eklatant, e që e kemi në praktikë që tregon qartë qëllimin kolonizator të Serbisë nëpërmjet instalimit të strukturës shtetërore dhe masave të dhunshme, është edhe rasti i Deçanit. Në vitin '92 dhe vitin '97 ndërmarrjet shoqërore, që udhëhiqeshin nga strukturat e masave të dhunshme, nëpërmjet kontratës së dhurimit, ia falën Manastirit të Deçanit paluajtshmërinë, që ishte në pronën e ndërmarrjeve “Apiko” dhe “Iliria”.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nëpërmjet inicimit të këtij debati parlamentar për çështjen e shpronësimit politik të pasurisë kombëtare të popullit të Kosovës synon që si rezultat i këtij debati parlamentar, Kuvendi i Kosovës të shprehë vullnetin e tij ligjvënës lidhur me shpalljen e pavlefshmërisë së të gjitha kontratave, me të cilat është tjetërsuar prona publike dhe shoqërore.

Ne mendojmë se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në cilësinë e organit më të lartë legjislativ në vend, duhet ta nxjerrë një rezolutë, me të cilën do ta kishte shpallur pavlefshmërinë juridike të të gjitha kontratave dhe marrëveshjeve nëpërmjet të cilave është bërë tjetërsimi i pronës publike dhe shoqërore, në përjashtim të transaksioneve pronësore që janë bërë me personat fizikë, përkatësisht qytetarët e Republikës së Kosovës.

Më pas, ai paraqiti para Kuvendit tekstin e propozim-Rezolutës, e cila i përmban katër pika.

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ideja e spastrimit etnik dhe politikat hegjemoniste serbe të kohës së Milosheviqit ndaj popullatës shqiptare, si në teori, ashtu edhe në praktikë, ku një nga këto elemente ishte edhe kolonizimi si objekt i shpërnguljes, tokat e marra në mënyrë kundërligjore, ishin politika dhe plane kundër popullatës shqiptare, jo vetëm për ndryshimin etnik, por edhe në ato me përmasa gjenocidale, sidomos edhe në luftën e fundit.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga institucionet shtetërore të Kosovës dhe gjithë spektri politik i vendit, e veçmas institucionet e drejtësisë, ta mbrojnë Kushtetutën e vendit dhe ligjet e saj pozitive, të cilat duhet të jenë në favor të interesave të përgjithshme, si dhe në avancimin dhe prosperitetin ekonomik të vendit tonë.

Në vazhdim, ai u fokusua në një vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i cili e ka miratuar kontratën, e cila për qytetarët e Komunës së Deçanit konsiderohet e paligjshme, ndërmjet AKM-së dhe Manastirit të Deçanit, mbi faljen e pronave të dy ndërmarrjeve publike, asaj “Apiko” dhe “Iliria”. Kjo theksohet se ka ndodhur nga neglizhenca e institucioneve vendore, por edhe ndërkombëtare për ta respektuar ligjshmërinë dhe respektuar institucionet përkatëse, dy ndërmarrje publike dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se një prej aspekteve më brutale të pushtimit të Kosovës nga Serbia, krah për krah me dhunën ndaj shqiptarëve, ishte tjetërsimi sistematik i pronës publike dhe shoqërore në Kosovë.

Vendimet e Serbisë së Milosheviqit, që e kanë tjetërsuar pasurinë tonë të përbashkët, ende kanë efekte konkrete juridike në Kosovë, 5 vjet pas shpalljes së Pavarësisë, si dhe 14 vjet pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë.

Këtu tashmë u përmend disa herë çështja e pronave të uzurpuara publike në Manastirin e Deçanit, sipas një vendimit të Parlamentit serb në kohën e Slobodan Milosheviqit. Por, e njëjta mund të thuhet edhe për tjetërsimin e pronës së Universitetit të Prishtinës, si dhe fillimin e ndërtimit të një kishë ortodokse aty brenda hapësirës së uzurpuar të Universitetit të Prishtinës, por një kishë e Mesjetës, por një kishë e viteve të '90-ta.

Dhe, a nuk qëndron e njëjta logjikë edhe me “Trepçën”, me ndërmarrjen tonë, në gjigantin ekonomik të Kosovës dikur. Tash Kosovës po i kërkohet t’i bartë pasojat financiare në formë të borxhit të jashtëm, për shkak të kolonizimit të egër të kohës së Milosheviqit.

Më pas, ai e shtroi pyetjen se a është diskriminues vendimi i Serbisë i vitit 1997, që Manastirit të Deçanit t’i kalohet pronësia e ndërmarrjeve tona publike? Nuk ka dyshim se vendime të tilla janë diskriminuese dhe uzurpuese.

Në fund, ai theksoi se ne kurrë nuk do të jemi shtet i pavarur, pa u shfuqizuar të gjitha vendimet e Serbisë në Kosovë, e sidomos ato gjatë viteve të '90-ta, pavarësisht se me çfarë mbështjellësi janë paketuar ato, qoftë edhe me mbështjellësin fetar, vendime të tilla si ky i EULEX-it për ta njohur uzurpimin e pronave nga Manastiri i Deçanit.

Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se tjetërsimi i pronës publike dhe shoqërore nga regjimi i Milosheviqit, nëpërmjet masave të dhunshme ka qenë një dukuri, që është bërë ndërmjet viteve 1989-1999. Një dukuri e tillë është bërë edhe për ndërmarrjet “Apiko” dhe “Iliria” në Deçan.

Manastiri i Deçanit posedon me pronë të paluajtshme në sipërfaqe prej rreth 52 hektarësh, kjo në bazë të aerofotografimit të vitit 1983, i cili është fuqizuar në vitin 1990, me ç’rast Manastiri e ka pranuar këtë gjendje dhe i ka nënshkruar fletëregjistrimet e aerofotografimit. Në vitin 1993, së pari ndërmarrja hoteliere “Slloga” nga Prishtina, në kuadër të së cilës ka qenë i integruar në mënyrë të dhunshme edhe hoteli i Deçanit me kontratë mbi falje numër 1235, ia fal Dioçezës së Rashkës dhe Prizrenit paluajtshmërinë e hotelit të Deçanit me të gjitha objektet përcjellëse, përkatësisht gjithsej 11 hektarë 40 arë e 51 metër, kontratë e cila nuk është zbatuar asnjëherë, sepse ka qenë antiligjore edhe sipas ligjeve të atëhershme në fuqi.

Më vonë në vitin 1997, Qeveria e Serbisë bën kontratë faljeje 04 numër 464-2914/97 me Manastirin e Deçanit dhe ia falë ngastrat e hotelit, të cilat ia kish falur më parë edhe “Slloga”, në sipërfaqe prej 11 hektarësh 40 arë e 51 metra, si dhe ngastrat e ndërmarrjes “Apiko” në sipërfaqe prej 12 hektarë 5 arë e 12 metra, si dhe objektin e mermerit në sipërfaqe prej 1 ar e 92 metra, krejtësisht 23 hektarë, 47 arë e 55 metra.

Qytetarët e Deçanit nuk janë ata që pretendojnë tokat e Manastirit, por Manastiri është duke pretenduar për t’i marrë pronat, të cilat do ta pengojnë zhvillimin e komunës dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e kundërshtojmë iniciativën e tillë për debat në Kuvend për faktin se kjo çështje ka të bëjë me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për kthimin e pasurisë së Manastirit të Deçanit.

Propozim-Rezoluta e paraqitur nuk mund të ketë veprim retroaktiv juridik, ngase nuk mund të jetë mbi Kushtetutën e vendit.

Sipas nenit 4.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

Në fund, ai i ftoi deputetët e Kuvendit që të mos e miratojnë propozim-Rezolutën, ngase, sipas tij, ajo është në kundërshtim me interesat e komunitetit serb.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Albulena Haxhiu, Goran Marinković, Armend Zemaj, Shaip Muja, Albin Kurti, Halit Krasniqi, Alma Lama, Visar Ymeri, Time Kadrijaj, nënkryetari i Kuvendit Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni, kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi dhe Muhamet Mustafa**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti **Liburn Aliu**, në emër të propozuesit të çështjes, në fund të debatit e paraqiti tekstin e propozim-Rezolutës për miratim nga Kuvendi.

Në mungesë të kuorumit, kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:30 minuta, ndërsa për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare.

E mërkurë, më 10 prill 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 4 dhe 5 prill

Kryetari procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës, si në vijim:

- Votimi i Rezolutës lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare të mbajtur më 5 prill 2013, mirëpo për shkak të mungesës së kuorumit nuk ishte proceduar me votim.

Kryetari e hodhi në votim propozim-Rezolutën e paraqitur nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 20

Kundër ----- 36

Abstenime -----4

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi propozim- Rezolutën e paraqitur nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999.

- Debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimitarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi.

Ai e ftoi deputetin Ramiz Kelmendi, që në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta marrë fjalën.

Ramiz Kelmendi, në cilësinë e propozuesit të çështjes tha se numri i madh i të papunëve dhe një gjenerate të rinjve të arsimuar që me energjinë dhe vullnetin që kanë për të punuar dhe për bërë afaristë, si dhe afaristëve ekzistues t'u mundësohet rritja dhe konkurrenca në tregun vendorë dhe ndërkombëtarë, e kjo mund të arrihet nëse do të bëhen këto ndryshime fiskale.

Shpesh mendohet se ndryshimet fiskale të caktuara e dëmtojnë buxhetin e aprovuar të Kosovës, që sipas mendimit të analizave profesionale të grupit të ekspertëve të AAK-së, me këtë rast nuk e dëmtojnë buxhetin, por e shtrijnë inkasimin e tyre, në mënyrë horizontale i inkasojnë taksat, duke ezvogëluar informalitetin e lartë dhe tatimet nga shtimi i numrit të punësuarve, konsumit dhe shtimit të eksportit që mund të vijë shumë shpejt dhe eliminimin e diskriminimit që këto politika u janë sjellë prodhuesve vendorë, duke i sjellë këta në disfavor me prodhuesit e shteteve të rajonit, e që rastin tonë, përveç që janë konkurrues, janë edhe politikisht të dëmshëm.

Së pari, do të filloj nga TVSH-ja e paguar në impute për prodhim agrar, të rimbursimit në vlerë prej 6% për ato prodhime që qarkullojnë në mënyrë legale. Kjo ekonomi është elementare dhe punëson shumë njerëz, po ashtu është resurs i pashtershëm, por te kjo prodhimtari, që në shumicën e rasteve është individuale për shkak të sipërfaqeve të vogla të punueshme të tokës për familje, për të punuar dhe përpunuar përdoren shumë impute, të cilat kanë në përmbajtje, si TVSH-në, doganën apo edhe akcizën, siç është për shembull karburanti ku në hyrje paguhet TVSH-ja, akcizën që sipas përlllogaritjes të gjitha këto prodhime që janë agrare e kanë në përmbajtje të vet 6% të TVSH-së që ishte dashur të rimbursohen.

Në vazhdim, ai tha se çështja e dytë është dogana 10% në të gjitha repromaterialet, ambalazhet e nevojshme për përpunim dhe prodhim, si dhe pjesët rezervë të makinave prodhuese.

Dogana 10% të hiqet për repromaterialet që përdoren për prodhim dhe përpunim në të gjitha ekonomitë, e në veçanti te ato të industrisë së tekstilit, industria e këpucëve, industria ushqimore dhe shumë industrive që punësojnë njerëz, e në veçanti gjininë femërore.

Dogana duhet të qëndrojë në produkte të gatshme edhe më tutje dhe për çdo marrëveshje të re që nënshkruhet, sidomos me shtetet që kanë ekspansion të fuqishëm, duke i seleksionuar ato produkte të cilat i shuajnë ekonomitë tona, e që janë fillestare dhe të pafuqishme për të konkurruar konkurrencën në bazë të ligjeve që janë në fuqi.

Pika e tretë është TVSH-ja në makineri prodhuese dhe makineritë tjera të cilat janë në funksion të zhvillimit ekonomik.

Çka është TVSH-ja 16%, në makineri dhe makineri prodhuese apo transportuese? Është TVSH-ja që paguhet në hyrje gjatë importit, që është së pari ngarkesë fillestare për të gjitha ekonomitë vijuese, e në veçanti ato fillestare. E që sipas ligjeve në fuqi të gjitha këto TVSH të paguara kthehen përsëri menjëherë pas fillimit të procesit të punës.

Këto tri pika shumë të rëndësishme në lëmin fiskal për zhvillimin ekonomik të Kosovës mundësojnë ndryshime radikale prodhuese dhe eksportuese, e që i nevojiten shumë Kosovës.

Edhe një herë dua cek se implementimi i këtyre pikave, i analizuar nga grupi i ekspertëve të AAK-së, nuk e zvogëlon buxhetin e aprovuar të Kosovës dhe nuk bie ndesh me ligjet ekzistuese, por e bën buxhetin më stabil dhe më të qëndrueshëm.

Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se nëse e analizojmë tërë sistemin fiskal dhe nëse i analizojmë politikat fiskale, shohim që në vazhdimësi ka ardhur duke u bërë një përsosje e politikave fiskale me qëllim të përkrahjes së bizneseve dhe krijimit të kushteve më të favorshme për këto biznese.

Këto politika kanë përfshirë vendime administrative, akte ligjore dhe nënligjore e të tjera, të cilat janë bërë krejtësisht në favor të këtyre politikave për t'iu lehtësuar puna bizneseve.

Lirimet nga tatimet doganore të propozuara kryesisht përfshijnë lëndën e parë dhe gjysmëproduktet, të cilat përdoren në prodhim, vijat e prodhimit, makina të veçanta dhe të kombinuara të të gjitha llojeve që shërbejnë për prodhim, pastaj pajisjet për ofrimin e shërbimeve të teknologjisë informative, sektor ky i cili është duke u zhvilluar me të madhe në vendin tonë.

Meqenëse ne si deputetë kemi mundësi të bëjmë plotësim-ndryshime të ligjeve, është mirë që të konkretizohen çështjet dhe deputetët të kërkojnë apo të marrin iniciativa për plotësime e ndryshime të ligjeve, apo në kuadër të ligjeve të cilat i kemi në Kuvend të insistojnë që të futen edhe ato çështje, të cilat ata mendojnë se duhet përmirësuar.

Mirëpo, ngritja e çështjeve kështu në formë të rekomandimeve, mendoj se nuk prodhon kurrfarë efekti, sepse edhe nëse ne i miratojmë këto rekomandime nuk do të bëjmë ndonjë zgjidhje. E mira e së mirës është që deputetët të angazhohen që çështjet të cilat mendojnë se janë në favor të zhvillimit ekonomik, në përgjithësi, t'i bëjnë me plotësim-ndryshimet e ligjeve dhe këto ligje të miratohen në Kuvend dhe mandej janë obligative që të realizohen dhe sjellin efekte më të mëdha se sa rekomandimet.

Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ekonomia në Kosovë duhet të sigurojë zhvillimin e saj stabil, afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Ashtu që në një afat sa më të shkurtër të arrihet shkalla mesatare e zhvillimit në rajon dhe në Bashkimin Evropian.

Nuk ekziston ndonjë formulë e përgjithshme, por për këtë arsye ekzistojnë parimet ekonomike me të cilat çdo program i zhvillimit ekonomik duhet të bazohet në kushte specifike, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore e tjerë.

Për rritjen e ekonomisë është me rëndësi një politikë e mirë ekonomike nëpërmjet rritjes së investimeve të faktorit prodhues, nëpërmjet rritjes së investimeve. Një politikë e mirë ekonomike mund që nëpërmjet investimeve më të vogla ta nxjerrë një shkallë më të lartë të rritjes.

Kusht i domosdoshëm i ndërtimit të shoqërisë demokratike është ekonomia e tregut. Në një ekonomi jo të tregut nuk mund të zhvillohet demokracia politike. Megjithatë, ekonomia e tregut nuk është kusht i mjaftueshëm për demokraci politike.

Në një afat më të gjatë, qëllimi i politikës fiskale është stimulimi i zhvillimit ekonomik. Duke qenë se investimet janë kusht i rritjes ekonomike, kjo do të thotë që politika tatimore duhet të nxisë investime të reja, e nëpërmjet saj të bëjë rritjen e sasisë së kapitalit prodhues.

Zvogëlimi i shkallës efektive të tatimit të propozuar nga deputeti Kelmendi ndikon në rritjen e investimeve në një normë të dhënë interesi, sepse në këtë mënyrë do ta nxisë më së shumti shkallën e rritjes ekonomike.

Grupi Parlamentar i LDK-së i përkrah rekomandimet e deputetit Kelmendi dhe do t'i votojë si të tilla.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se do të dëshironte që debati i sotëm të mos degradojë në disa çështje jashtëzakonisht teknike të ndryshimeve të disa normave tatimore, të cilat nuk po e them se nuk do ta ndihmonin prodhimin vendor, por nuk është se do ta zgjidhnin çështjen e prodhimit vendor.

Pra, është ditur natyrisht që një ekonomi që nuk prodhon nuk mund të jetë ekonomi e qëndrueshme. Dhe, kjo është dëshmuar në secilën situatë krize, që e ka kapluar globin.

Ndërkohë që ekonomia e Kosovës është një ekonomi, e cila që prej fillimit prej vitit 1999 e tutje, e veçanërisht prej procesit të privatizimit, është një ekonomi, e cila ka synuar të ndërtohet mbrapsht. Pra, ka synuar që të ndërtojë shërbime, nëpërmjet shkatërrimit të prodhimit, i cili ka ndodhur nëpërmjet procesit të privatizimit, ku një pjesë e konsiderueshme e potencialit prodhues që ka pasur Kosova është shkatërruar nëpërmjet këtij privatizimi dhe, në anën tjetër, duke përdorur politika të tilla edhe fiskale, të cilat e kanë shkatërruar prodhimin vendor, pra e kanë shkatërruar mundësinë e prodhimit vendor.

Prodhimi është shtimi real i vlerës, prandaj edhe prodhimi e bën ekonominë e qëndrueshme, pra vlera e shtuar vërtet ndodh në prodhim, ndërkohë që në tregti kjo vlerë e shtuar është vlerë fiktive e shtuar, është vlerë financiare. Prodhimi në Kosovë ballafaqohet edhe me politika jo të favorshme tatimore, edhe me politika jo të favorshme fiskale në përgjithësi, mirëpo problemi kryesor i prodhimit nuk janë këto politika, siç edhe kanë treguar disa herë madje edhe prodhuesit që janë drejtpërdrejt të përfshirë në këtë. Ai theksoi se prodhimi rritet për aq sa rritet tregu dhe mundësia për t'i tregtuar produktet e veta dhe se në këtë drejtim konsiderojmë që mbrojtja e tregut do të ishte një mekanizëm i domosdoshëm për ta siguruar vijueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e prodhimit në Kosovë, gjë që nuk ka ndodhur, nuk po ndodh as sot, dhe as që po kërkohet sot nga ky Kuvend.

Pra, për t'i ndihmuar prodhimin të vendit, zoti Kelmendi, unë të kisha sugjeruar që ta ndalësh për shembull “Bambi”-n, të mos e sjellësh më në Kosovë, se kështu do t'i kishe ndihmuar të paktën një prodhuesi të Kosovës dhe me këtë i kishe ndihmuar prodhimin, në përgjithësi.

Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se do të bëjë përpjekje që ato çka u përmendën t'i largojë. Mirëpo, është një temë shumë e rëndësishme që po bëhet debat në këtë Kuvend, për arsye se Kosova ka politikë të vet monetare për arsye se euroja si mjet pagese nuk emitohet në Kosovë, do të thotë Banka Qendrore e Kosovës nuk e bën emitimin e euros dhe i vetmi kah i zhvillimit ekonomik është politikat fiskale dhe që luajnë një rol kyç në orientimin e zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Me këtë politikë fiskale dëshirohet të favorizohet prodhimi vendor, sepse të gjitha produktet janë të importuara, jo vetëm nga kompania e zotit Kelmendi, por të gjitha kompanitë në Kosovë.

Prandaj, me këto politika po dëshirohet pse të rritet prodhimtaria vendore, e sidomos prodhimtaria bujqësore, ku mbi 500 milionë dalin nga Buxheti i Kosovës për produkte

bujqësore ushqimore, të cilat mund të prodhohen në vend. Po, nëse në Kosovë nuk bëhen politika të favorshme fiskale, atëherë me siguri që kjo do të zgjasë edhe me vite të tëra.

Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, tha se e përkrah debatin e iniciuar nga deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramiz Kelmendi, dhe është mirë të debatohet në Parlamentin e Kosovës për ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes së rritjes së prodhimit vendor dhe të zhvillimit ekonomik në tërësi.

Nëse e shohim zhvillimin ekonomik në Kosovë, mund të themi se edhe ne si deputetë dhe si qytetarë të Kosovës nuk jemi shumë të kënaqur.

Në Kuvendin e Kosovës është miratuar një numër i madh i ligjeve për ndryshimin e politikave ekonomike në Kosovë dhe një numër i ligjeve, të cilat nuk janë miratuar në Kuvendin e Kosovës për arsye politike, siç është Ligji për investimet e huaja.

Duhet të kemi kujdes edhe ne si deputetë dhe Qeveria që gjatë miratimit të ligjeve të kërkojmë favorizim për investorët vendorë dhe prodhimi vendor, e jo të ngrehim debate, se me debate dhe rekomandime nuk mund të arrijmë që t'i plotësojmë politikat fiskale në favor të investorëve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Ramiz Lladrovci, Hykmete Bajrami, Afrim Kasolli, Kimete Bajraktari, Nijazi Idrizi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Albin Kurti, Aurora Bakalli, Time Kadrijaj, Jakup Krasniqi, Hashim Deshishku, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Muhamet Mustafa, Halit Krasniqi, Sali Morina, Liburn Aliu, Teuta Haxhiu, Lutfi Zharku, Teuta Sahatqija, Arben Gashi dhe Safete Hadërgjonaj**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, deputeti Ramiz Kelmendi, në emër të propozuesit të çështjes, e paraqiti tekstin e rekomandimeve për miratim.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e paraqitura nga deputeti Ramiz Kelmendi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----23,
Kundër -----33,
Abstenime -----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e paraqitura nga deputeti Ramiz Kelmendi lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimtarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi

3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar vendimin e presidentes së Kosovës për kthimin në Kuvend të Ligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, i njoftoi deputetët se në ndërkohë është paraqitur edhe një amendament nga GP i LDK-së. Ajo kërkoi nga Kuvendi që kjo çështje të kthehet edhe një herë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Komisionin për Legjislacion për shqyrtim.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, e përkrahu propozimin e deputetes Safete Hadërgjonaj.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetes Safete Hadërgjonaj.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicën absolute të votave, mori këtë:

V E N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion që ta rishqyrtojë vendimin e presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjin nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ajo tha se si komision e kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Deputetja Safete Hadërgjonaj më pas i paraqiti para Kuvendit rekomandimet, të cilat janë paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL. Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti. Diskutimi i deputetes Safete Hadërgjonaj është dhënë i plotë ne transkript.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të

Koalicioni Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Muhamet Mustafa, Salih Morina dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 43,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012

Deputetja Safete Hadergjona, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund e përkrahu raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicioni Kosova e Re, si dhe Muhamet Mustafa dhe Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pasi nuk pati kuorum për procedimin me votim të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari tha se do të vazhdojmë me diskutimet në pikën vijuese.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012

Deputetja Safete Hadergjona, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund e përkrahu raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012.

Kryetari e hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Ali Sadriu dhe Donika Kadaç-Bujupi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pasi nuk pati kuorum për procedimin me votim të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari i shpalli të mbyllura punimet për mbledhjen e sotme, ndërsa vazhdimi i saj do të bëhet më 11 prill 2013, në orën 10:00.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e sotme në orën 16:45 minuta

E enjte, 11 prill 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 4, 5 dhe 10 prill 2013

Kryetari procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës, si në vijim:

- Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e datës 10 prill 2013, por në mungesë të kuorumit nuk ka qenë e mundur të procedohet me votim.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 36,

Kundër ----- 18,

Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012.

- Votimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e datës 10 prill 2013, por në mungesë të kuorumit nuk ka qenë e mundur të procedohet me votim.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 36,

Kundër ----- 27,

Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012.

- Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Enis Kervan e ka liru pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, pas kërkesave të deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

Pastaj, kryetari i njoftoi deputetët me marrëveshjen e Grupit Parlamentar “6+”, të datës 28 mars 2013, për caktimin e nënkryetarit të Kuvendit nga radha e komuniteteve tjera, që nuk janë shumicë dhe joserbe, e cila ka paraparë zgjedhjen e nënkryetarit me rotacion, si në vijim:

1. Prej 1.4.2013 deri më 30.9.2013, deputeti Rasim Demiri (komuniteti boshnjak),
2. Prej 1.10.2013 deri më 30.04.2014, deputeti Albert Kinolli (komuniteti rom),
3. Prej 1.5.2014 deri më 30.9.2014, deputeti Etem Arifi (komuniteti ashkali).

Kryetari sqaroi se për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nevojiten shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra së paku 61 vota.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin për zgjedhjen z. Rasim Demiri nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi kërkesën për zgjedhjen e z. Rasim Demiri nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 10.35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale